



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 17, datë 07.06.2016

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE ZHVILLIMI DHE NDËRTIMI BRENDA
ZONAVE TË RËNDËSISË KOMBËTARE

Në mbështetje të neneve 28, pika 1, dhe nenit 29, të Kodit të Procedurave Administrative, neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 19 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Deri në miratimin e dokumenteve të planifikimit për zonat e rëndësisë kombëtare, autoritetet e zhvillimit të territorit mund të vijnë me procedurat administrative dhe ligjore për shqyrtimin dhe vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në zonat e rëndësisë kombëtare, si vijon:
 - a) për territoret ku ka plane të përgjithshme vendore në fuqi, sipas hartës bashkëlidhur VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, shqyrtimi dhe miratimi të kryhet në përputhje me këto plane dhe vetëm pas marrjes së përputhshmërisë nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit;
 - b) për territoret ku nuk ka plane të përgjithshme vendore në fuqi, kërkesat për leje të merren në shqyrtim vetëm për kategoritë dhe zonat e përcaktuara nga Vendimi Nr. 1, datë 30.07.2015 i Këshillit Kombëtar të Territorit “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”, i ndryshuar, dhe në çdo rast pas marrjes së përputhshmërisë nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Këshilli Kombëtar i Territorit vijon me shqyrtimin e kërkesave për zhvillim në zonat e rëndësisë kombëtare për të gjitha llojet e zhvillimit komplekse, sipas nenit 19 të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA



DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe autoritetet vendore të zhvillimit të territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

KRYETARI

EDI RAMA

